

VENDIM
Nr.2, datë 21.7.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese

Në mungesë të anëtarëve Feti Gjilani, Manol Konomi e Hilmi Dakli, për arsye shëndetësore me sekretar Ylli Mahmuda, më datën 20-21 korrik 1992, shqyrtoi në seancë gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr.3 që i përket:

KËRKUES: Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI I KËRKESËS

Ndalimi i veprimtarisë së mëtejshme të organizatës së vetëmëruar "Bashkimi i Kuadrove Ushtarakë në Rezervë" si antikushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatimin e çështjes

VËREN:

Këshilli i Ministrave me shkresën Nr.1868, datë 17.07.1992, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, midis të tjerave, parashtroi, se kohët e fundit, në disa mjete të informacionit masiv, është propaganduar një organizatë e vetëmëruar dhe e pamiruar "Bashkimi i Kuadrove Ushtarakë në Rezervë", e cila, me veprimtarinë dhe aktivitetin e saj, po sjell ndikime destabilizuese në radhët e ushtarakëve, duke penguar kështu proceset e reformimit dhe të demokratizimit të Forcave të Armatosura.

Meqënëse veprimtaria e saj antikushtetuese bie ndesh me interesat e mbrojtjes së vendit dhe të ushtrisë, në atë ankesë kërkohet të mbahet qëndrim, sipas ligjeve në fuqi ndaj organizatorëve të saj.

Siç rezulton nga materialet e çështjes, një grup nismëtar si komision organizator, me një kërkesë të veçantë që mban datën 17.04.1992, drejtuar Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Rendit Publik, Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe për dijeni Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave, kërkon njohjen e organizatës "Bashkimi i Kuadrove Ushtarakë në Rezervë" (në pension) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë duke paraqitur njëkohësisht projekt statutin e organizatës si dhe programin e saj.

Kjo kërkesë është bërë pasi ky grup organizator ka marrë përgjigje negative nga Ministri i Drejtësisë si organ jo kompetent për njohjen e saj.

Me urdhërin e tij Nr.91, datë 18.05.1992, Ministri i Mbrojtjes nuk e ka miratuar krijimin e kësaj organizate, me motivacionin se kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr.2362, datë 16.10.1956 "Mbi organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike", në të cilën nuk parashikohet që një organizatë shoqërore të miratohet nga tre dikastere.

Ministri i Rendit Publik, me shkresën Nr.324/1, datë 17.07.1992, e ka njoftuar Komisionin nismëtar për formimin e Organizatës "Bashkimi i Kuadrove Ushtarakë në Rezervë", se nuk miraton krijimin e saj.

Nga ana e Shërbimit Informativ Kombëtar, të interesuarit nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Siç vërehet nga materialet e çështjes dhe nga vetë thëniet e përfaqësuesve të grupit organizator, komisioni nismëtar, muaj më parë, me cilësinë e komisionit organizator të "Bashkimit të

Kuadrove Ushtarakë në Rezervë", ka zhvilluar shumë aktivitete në qendër e në rrethe, ka lëshuar deklarata të ndryshme dhe ka dhënë për botim ose për komunikim në organet e informacionit masiv, akte të tilla në të cilat është bërë fjalë për qëndrime të caktuara ndaj Forcave të Armatosura dhe reformave që po bëhen në to. Si të tilla mund të përmendim deklaratën e botuar në gazetën "Zëri i Popullit", të datës 13 korrik të këtij viti; atë të botuar në gazetën "Kombi"; mitingjet në Tiranë etj.

Të gjitha këto veprimtari i ka zhvilluar me cilësinë e të Komisionit organizator të "BKUR".

Këto veprime vijnë në kundërshtim me përmbushjen e nenit 12 të ligjit të përmendur. Sipas kësaj dispozite deri në ditën e dhënies së pëlqimit nga organi kompetent shtetëror për njohjen e organizatës, grupi nismëtar ka të drejtë të bëjë vetëm ato veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, dmth ato veprime që kanë vetëm karakter konstruktiv, si të thërrasë mbledhjen e themeluesve të saj, të caktojë organin organizativ etj, të këtij lloji.

Në mbështetje edhe të nenit 16 të Ligjit Nr.7502, datë 25.07.1992, "Për partitë politike", asnjë parti apo organizatë politike ose shoqërore nuk ka të drejtë të zhvillojë veprimtari në përmbajtje të së cilës trajtohen ose bëhen fjalë tërësisht apo pjesërisht për objektivat ose qëllimet e krijimit të kësaj organizate, të marrë vendime dhe të mbajë qëndrim për të, para miratimit të saj nga organi kompetent shtetëror e as të shprehen në emër të saj zyrtarisht.

Po kështu, organet e informacionit masiv ndalohen të botojnë vendime, rezoluta, deklarata dhe dokumenta të tjera të çdo lloji, ose t'i transmetojnë ato në emër të partive, organizatave politike dhe atyre shoqërore, në rastet kur këto të fundit nuk janë miratuara rregullisht.

Një ndalesë e tillë nuk cënon aspak lirinë e shtypit. Cilido, individualisht ose së bashku me persona të tjerë, ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e pikëpamjet e tij në shtyp dhe në organet e tjera të informacionit masiv.

Grupi organizator, në mbështetje të nenit 29 të ligjit në fjalë, ka të drejtë të ankohet zyrtarisht dhe me shkrim kundër vendimit të Ministrit të Mbrojtjes dhe atij të Rendit, në organin më të lartë shtetëror, që në rastin konkret është Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të pikës "6" të nenit 24 e 25 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VENDOSI:

Të shpallë të paligjshme veprimtarinë e deritanishme të organizatës së pamiraturar të "Bashkimi i Kuadrove Ushtarakë në Rezervë" dhe të ndalojë veprimtarinë e mëtejshme të saj.

Ky vendim është i formës së prerë.

Tiranë, më 21.7.1992